

## F2. FORMULARI I MIRATIMIT TË PRINDIT

I dashur prind,

Instituti ATOMI, me përkrahje nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), është duke zbatuar Projektin ATOMI, i cili ka për qëllim identifikimin dhe përkrahjen e personave me inteligjencë të jashtëzakonshme (atomistë).

Për nevojat e këtij projekti do të bashkëpunohet ngushtë me prindërit, mësime dhe personat tjerë, të cilët mund të kontribuojnë në realizimin e qëllimit dhe objektivave të projektit. Ky projekt synon të përfshijë të gjithë nxënësit prej klasës VIII deri XI nga të gjitha shkollat e Kosovës, përkatësisht do t'u ofrojë mundësi të barabarta të gjithë këtyre nxënësve që të aplikojnë apo të nominohen.

Pas procesit të aplikimit, aplikuesit do t'i nënshtrohen një procesi disafazësh të seleksionimit, i cili do të realizohet përmes përdorimit të testeve të standardizuara të inteligjencës, nga i cili do të përzgjidhen nxënësit më të mirë (që e plotësojnë kriterin e përcaktuar nga Instituti ATOMI për të qenë atomist), të cilëve synohet që t'ju ofrohen shërbime dhe aktivitete të ndryshme përkrahëse, si: kurse të avancuara (Shkolla+), kamp veror, takime me profesionistë dhe personalitete të shquara, orientim në karrierë dhe këshillim psikologjik, ndërmjetësim për bursa, klub të atomistëve për aktivitete të përbashkëta, aktivitete kulturore, sociale, sportive e rekreative, etj.. Të gjitha shërbimet dhe aktivitetet e përmendura më sipër ofrohen falas nga Instituti ATOMI.

Për më shumë informata rreth projektit vizitoni faqen e internetit [www.atomi-ks.org](http://www.atomi-ks.org). Nëse keni nevojë për ndonjë pyetje apo sqarim shtesë, kontaktoni në 045 460 320 ose [info@atomi-ks.org](mailto:info@atomi-ks.org).

Instituti ATOMI merr përsipër të mbrojë të gjitha të dhënat personale të të gjithë pjesëmarrësve në këtë projekt, duke e ruajtur konfidencialitetin e plotë të tyre. Të gjitha të dhënat e grumbulluara gjatë këtij projekti, Instituti ATOMI mund t'i shfrytëzojë për publikime shkencore, duke mbrojtur plotësisht të dhënat personale dhe duke mos cenuar konfidencialitetin e këtyre të dhënave.

*Aplikimi dhe vlerësimi i fëmijës suaj nuk siguron drejtpërdrejt kualifikimin e tij për pjesëmarrje në aktivitetet dhe përfitimet e mëtutjeshme që parashihen me këtë projekt.*

**Me rastin e nënshkrimit të këtij formulari, unë deklaroj se jam informuar me procedurat dhe aktivitetet e Projektit ATOMI dhe jap miratimin tim që fëmija im të aplikojë dhe të jetë pjesë e këtij projekti.**

**Emri dhe mbiemri i fëmijës:** \_\_\_\_\_ **Emri dhe mbiemri i prindit:** \_\_\_\_\_

**Nënshkrimi i prindit (kujdestarit të familjes):** \_\_\_\_\_ **Data:** \_\_\_\_\_

**Vërejtje:** Miratimi nga ana e prindit është i domosdoshëm në mënyrë që aplikacioni të jetë i vlefshëm.